



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.03, datë 24.11.2021

PËR
MIRATIMIN E KORRIGJIMIT TË PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR
BASHKIA PËRMET, TË MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 3 DATË 10.06.2020,
TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT

Në mbështetje të neneve 7, 20, 25 dhe 26 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të neneve 2 dhe 10 të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të ndryshuar, të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 3, datë 10.06.2020 të KKT-së “Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Përmet me propozim të Kryetarit të Bashkisë Përmet, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Në Planin e Përgjithshëm Vendor Bashkia Përmet, të miratuar me Vendim nr.3, datë 10.06.2020, të Këshillit Kombëtar të Territorit, të bëhen ndryshime në dokumentin e:
 - *Rregullores së Planit:*
 - Neni 92 “Kushte për njësi të veçanta”, pika 2, ndryshohen shkronjat “c”, “d”, “e” , paragrafi 2 i shkronjës “g” dhe shkronja “i”;
 - Tabelat e treguesve të zhvillimit të njësive strukturore PM_UB_AR1_76/5 dhe PM_UB_AR1_76/14.sipas Dokumentit të Korrigjimit të Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Përmet, bashkëlidhur këtij Vendimi.
2. Ngarkohet Bashkia Përmet dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për botimin e Vendimit dhe dokumentat shoqërues të tij, në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit, si dhe për përditësimin e informacionit GIS dhe platformës e-Harta, sipas ndryshimeve të miratuara.
3. Ngarkohen Bashkia Përmet, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, si dhe autoritetet përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

